KROME, ZGJEBE - SCABBIA

Kroma eshte nje semundje parazitare e shkaktuar nga nje insekt i vogel, femera barrse e te cilit hap disa galeri te vogla nen lekure dhe vendos vezet. Nga keto lindin insekte te tjera qe ne 8-16 dite behen te rritur, riprodhohen dhe pastaj shfaqen galeri te reja ne lekure. Ky cikel vazhdon deri sa nuk nderhyhet me nje kurim te pershtatshem (kroma nuk sherohet vetem).

Kroma eshte nje semundje ekskluzivisht njerezore. Infektimi ndodh nepermjet nje kontakti te drejtperdrejt, lekure me lekure, nga person i semure ne nje te shendoshet, kur per shembull flihet ne te njejtin shtrat ose, per te rriturit gjate raporteve seksuale.

Infektimi ndodh rralle ne menyre jo te drejtperdrejt nepermjet nderresave te shtratit, veshjeve ose peshqirve te perdorur pak me pare nga person i semure nga kroma; paraziti, ne fakt, nuk mbijeton gjate larg trupit te njeriut.

I semuri nuk eshte i konsideruar me ngjites pas perfundimit te mjekimit.

Kroma eshte e pranishme ne te gjithe boten. Ka disa vite qe rastet e kesaj semundje, jane rritur shume duke perfshire persona te te gjithe niveleve sociale dhe ekonomike pa dallim moshe, seksi, race ose kushteve te higjenes personale.

SI SHFAQET SEMUNDJA

Kroma shfaqet me te kruara, me te forta gjate nates, dhe me shfaqjen e galerive ne lekure. Siç thame jane galeri te vogla te hapura nga insekti, te gjata pak milimetra dhe me ngjyre gri ose te bardhe, qe perfundojne me nje fryerje ku ndodhet femera e rritur.

Te shpeshta jane plaget e lekures dhe gervishtjet nga te kruajturat qe mund edhe te infektohen.

Plaget e pershkruara jane me shpesh te lokalizuara ne hapesirat midis gishtave te duarve, ne kyçat e duarve, ne berryla, ne sqetulla, perreth belit, ne kofshet, perreth kerthises ne femijet, ne organet gjinore tek burrat, ne pjeset e poshtme te vitheve dhe perreth gjirit ye grave.

Ne foshnjet mund te jene te interesuar: koka, qafa, pellemba e duarve dhe shputa e kembeve.

E kruara mund te zgjas per disa jave edhe mbas sherimit.

Ne personat me imunodepresion plaget e lekures jane shpesh me te renda dhe me te perhapura dhe perkundrazi mund te mos kene te kruara.

CFARE DUHET TE BEHET PER TE PARANDALUAR PERHAPJEN E KROMES

Kur **shfaqen plage ne lekure te shoqeruara me te kruara te forta eshte shume e rendesishme t'ju drejtoni mjekut pa humbur kohe** dhe te beni kontrollet e duhura.

Ne qofte se behet diagnoza e kromes eshte e nevojshme t'ju nenshtroni ne menyre te perpikte mjekimeve dhe te merren te gjitha masat higjenike te rekomanduara qe permbajne, ne menyre te veçante, larjen ne uje te ngrohte (te pakten 60°C) te nderresave, te çarçafeve, te kellefeve dhe te peshqirve te perdorur nga i semuri.

Kroma nuk eshte nje semundje e rende, por eshte i larte rreziku i infektimit i personave te tjere, ne menyre te veçante pjesemarresve te familjes te cileve shpesh ju keshillohet te bejne te njejtin mjekim te te semurit edhe se nuk kane shqetesime.

I azhurnuar ne Qeshor 2003 / Aggiornato al Giugno 2003

I perkthyer nga Kooperativa INTEGRA / Tradotto da Cooperativa INTEGRA

Me kontibutin e Provinces se Modena / Con il contributo della Provincia di Modena

Per te ditur me teper drejtohuni ne:
Per saperne di più rivolgersi a: